Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**14.08.2024**	**23.08.2024**	**2024/0705**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.08.2024, OE "Arianit R. Bytyqi"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0705, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "Rener SHPK & PBC SHPK "- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirembajtje dhe avancim i sistemit te menaxhimit te rasteve-SMR -DRPRIH-Ri tender" me nr. të prokurimit: "214-24-4177-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 51,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 26/04/2024

Hapja e ofertave: 23/05/2024

Vendimi i AK-së: 18/07/2024

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0705 i dt:02.08.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04L-237, Ligjin Nr. 05L-068 dhe Ligjin Nr. 05L-092

Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME dhe Komisioni i Vlerësimit ka shpallur fitues me datë 18.07.2024 GOE RENER SHPK, PBC SHPK në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1.

Ne si OE NTSH UNISOFT kemi aplikuar në projektin në fjalë dhe jemi të përgjegjshëm, AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME ka kryer shkelje duke mos i përmbushur dhe respektuar detyrimet si autoritet kontraktues sipas nenit 1 të LPP.

Neni 59 paragrafi 1,2,4 - Ligjit Nr. 04L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04L-237, Ligjin Nr. 05L-068 dhe Ligjin Nr. 05L-092

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME dhe Komisioni i Vlerësimit i përbërë nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1, 7, 59
Dhe se ne si OE NTSH UNISOFT jemi ofertë e përgjegjshme dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj ne si OE pretendojmë që AK- MPB nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.
AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME nuk ka kryer ekzaminim të sakt sipas Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, lidhur me GOE të shpallur fitues me vendimin e datës 18.07.2024, pasi që ky GRO nuk i plotësojnë kërkesat e FDT dhe NJK.
AK- MPB nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK- MPB dhe komisioni vlerësues janë përgjegjës individualisht për trajtimin e ofertës GOE RENER SHPK, PBC SHPK në kundërshtim me LPP dhe RROUP.

Neni 7 Ligjit Nr. 04L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04L-237, Ligjin Nr. 05L-068 dhe Ligjin Nr. 05L-092

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Gjithashtu GOE RENER SHPK, PBC SHPK nuk i plotëson kërkesat ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me stafin profesional teknik. AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME Komisioni i Vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertat në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Shih dokumentacionet dhe provat shtesë të bashkangjitura ***Dokumente Prova Dokumenti shtesë***

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- MPB nuk ka trajtuar ne parim RROUP dhe LLP sipas nenit 7.

Ne si OE N.T.SH. UNISOFT me vendimin e AK-së datës 18.10.2023 për ta shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm GOE RENER SHPK, PBC SHPK ne si OE (NTSH UNISOFT) jemi të diskriminuar, pasi që jemi OE i cili jemi të përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat të cilat janë në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të

KRITERET PËR VLERËSIM

Tehničke i profesionalne mogućnosti	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet te ketë Menaxher të projektit– (1 Zyrtar) • Diplomë universitare Inxhinier i Kompiuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave ose inxhinierisë kompiuterike. •Përvojë pune, minimumi (5) vite pas diplomimit. •Të ketë menaxhuar 3 vitet e fundit të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjtë, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). •Duhet të jenë i Certifikuar në PMP ose ekuivalente. •Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit	**1.Për Udhëheqësin – Menaxherin e projektit duhet të dëshmoi me** • Diplomë Universitare përkatëse – (kopje). • Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje). • Letër reference nga punëdhënësit ose cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar –(Kopje). • Letër reference nga punëdhënësit ose cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (Kopje); • Certifikatës në PMP ose ekuivalente valide (certifikata e noterizuar ose linku për verifikimin e sajë), • Deklaratë nga OE te nënshkruar dhe vulosur. • CV-në.
2.Zhvillues të softuerit – (2 Zyrtar) • Diplomë në Bacelor i Inxhinierisë kompiuterike ose Bacelor i shkenca kompiuterike. • Përvojë pune, minimumi (3) vite pas diplomimi. • Të ketë të realizuar 3 vitet e fundit të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjtë, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET) si dhe Ueb Shërbime WEB API.	**2.Për Zhvillues të softuerit, duhet të dëshmoi** • Diplomë Universitare përkatëse – (kopje). • Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje). • Letër reference nga punëdhënësit ose cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar –(Kopje). • Letër reference nga punëdhënësit ose cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (Kopje); • CV-në.
3.Ekspert për Zhvillimin e Bazave të dhënave – (1 Zyrtar) •Diplomë në Bacelor i Inxhinierisë kompiuterike ose Bacelor i shkenca kompiuterike • Përvojë pune, minimumi (3) vite pas diplomimi. •Të ketë të realizuar 3 vitet e fundit të paktën një (1) projekt të natyrës së njëjtë, të zhvilluara në platformën Microsoft (baza e të dhënave në SQL Server).	**3.Dëshmitë per Ekspert për Zhvillimin e Bazave të të dhënave** • Diplomë Universitare përkatëse – (kopje). • Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje). • Letër reference nga punëdhënësit ose cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar –(Kopje). • Letër reference nga punëdhënësit ose cfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (Kopje); • CV-në.
4.Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë kontrata për Shërbime të ngjashme, kanë qenë në vlerë jo me pak se 70,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	**4.Listën e kontratave që specifikon shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin, duke ia bashkëngjitur dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë, (kopje).**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

DATË/A:	26.07.2024
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.), Rr. "Raif Pollomi", L1/2, Nr. 6 Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	e-prokurimit
NGA/OD/FROM:	Agim ISLAMI, Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit -MPB
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim, për Aktivitetin e prokurimit, "Mirëmbajtje dhe avancim i sistemit të menaxhimit të rasteve-SMR -DRPRIH-Ri tender", me nr. të prokurimit : 214-24-4177-2-2-1

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtimi të Tenderucsi, NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.), Prishtinë, të datës 23.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Mirëmbajtje dhe avancim i sistemit të menaxhimit të rasteve-SMR -DRPRIH-Ri tender", me nr. të prokurimit: 214-24-4177-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, mbështetur në Ligjit nr. *Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, neni 108/ A, nxjerr këtë:

VENDIM

1. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtime e Tenderuesit NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.), Prishtinë, **e pa bazuar**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtje dhe avancim i sistemit të menaxhimit të rasteve-SMR -DRPRIH-Ri tender", me nr. të prokurimit : 214-24-4177-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të publikuar me datë 18.07.2024.

Autoriteti Kontraktues-MPB, për këtë aktivitet të prokurimit të cekur më lartë, ka zhvilluar procedurën me të dhënat si vijon:

- B05 Njoftimi për kontrate, ... 29.04.2024;

1

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Arianit R. Bytyqi**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke ngritur disa pretendime në lidhje me vendimin e AK-së. Pretendimet e ngritura janë shqyrtuar dhe për to ka dhënë përgjigje eksperti si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"GOE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me stafin profesional teknik, ku në DT është kërkuar një menaxher i projektit- Inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, diploma e dorëzuar për znj. A.M.M. nuk i plotëson kriterin sipas dosjes."*

Eksperti shqyrtues sqaron se si kërkesë e kapacitetit teknik dhe profesional sa i përket stafit të angazhuar ka qenë që operatorët të kenë një menaxher të projektit i cili ka diplomë universitare në inxhinieri kompjuterike me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë pune minimum prej 5 vitesh pas diplomimit. OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e stafit sipas kërkesave, ku njëri prej tyre është emëruar menaxher i projektit ndërsa dy të tjerë janë emëruar si zëvendës menaxher të projektit. Menaxherja e projektit e emëruar ka dorëzuar dëshmitë, ndër to edhe diplomat e kërkuara. Nga dokumentet e dorëzuara shihet se për këtë menaxhere janë dorëzuar dy diploma, bachelor dhe ajo master. Nga diploma bachelor shihet se titulli i marrë pas diplomimit është titulli "Informatikan" dhe dega Informatikë, ndërsa diploma master e menaxheres së projektit është në studimet ekonomike evropiane. Sipas ekspertit këto diploma nuk përkojnë me kërkesat e dosjes së tenderit ku është kërkuar që menaxheri të ketë titullin inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion në rastin e studimeve themelore ose të ketë diplomë master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike. Eksperti pasqyron që edhe pse titulli

informatikan ka shumë ngjashmëri me programin shkenca kompjuterike megjithatë kjo diplomë do të mund të merrej se është relevante vetëm në rastin se do të ishte e nivelit master për t'u konsideruar në përputhje me kërkesat e dosjes, sepse siç e kemi sqaruar sa i përket studimeve themelore sipas kriterit të dosjes është kërkuar vetëm inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion dhe jo ndonjë drejtim tjetër. Andaj, sipas ekspertit ky kriter nuk është përmbushur nga operatori i rekomanduar dhe sipas kësaj që sqaruam vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar.

Pretendimi 2

"Kërkesa e DT-së dhe njoftimit për kontratë tek fleta e të dhënave të tenderit, ku është kërkuar menaxheri i projektit të jetë inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, për zv. menaxheren e projektit znj. D.A. sipas listës së dorëzuar, diploma nuk i plotëson kriterin e dosjes."

Pas analizimit të dokumenteve të dorëzuara për zv.menaxheren e projektit D.A., eksperti sqaron se së pari kërkesë e dosjes ka qenë që të emërohet vetëm një menaxher i projektit sipas kërkesave dhe dëshmive të kërkuara, pra nuk është kërkuar që të përcaktohen dhe të emërohen edhe zv.menaxher të tjerë. Megjithatë, operatori i rekomanduar ka dorëzuar në listë dhe ofertë edhe dokumentet për zv.menaxheren. Eksperti sqaron se zv.menaxherja ka dorëzuar në ofertë diplomën bachelor me titullin bachelor në shkencat e aplikuara dhe arte dhe diplomën master i shkencave të kontabilitetit. Sipas ekspertit asnjëra nga këto dy diploma nuk përmbushë kriterin e dosjes, andaj edhe nëse do ishte caktuar personi në fjalë si menaxhere e projektit, përsëri e njëjta nuk do të përmbushte kërkesat e kërkuara.

Pretendimi 3

"Është kërkuar sipas dosjes që menaxheri i projektit të jetë inxhinier i kompjuterikës me telekomunikacion ose master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, për zv. menaxherin e projektit, sipas listës z. M.B. është dorëzuar diploma e cila nuk i plotëson kriterin e dosjes dhe nuk ka përvojë 5 vjeçare pas diplomimit."

Në ofertë janë dorëzuar dokumentet edhe për një person tjetër nga stafi i cili është emëruar si zv.menaxher i projektit. Për zv.menaxherin M.B. është dorëzuar një diplomë bachelor me titullin bachelor i shkencave kompjuterike dhe inxhinieri. Diploma e dorëzuar sipas ekspertit nuk përkon me kërkesat e dosjes, ku për nivelin themelor është kërkuar drejtimi telekomunikacion ndërsa për master është lejuar edhe shkencat kompjuterike, përveç kësaj nuk është i përmbushur as kushti i dytë që menaxheri i projektit duhet të ketë minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Përderisa stafi M.B. ka përfunduar studimet në vitin 2020 atëherë vlerësojmë që nuk është përmbushur as kushti i përvojës së punës. Në anën tjetër po ashtu sqarojmë se në dosje të tenderit nuk ka pasur kërkesë për zv. menaxher të projektit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Arianit R. Bytyqi**

Agnese Ibrahimi